



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH

Nr ____ prot.,

Data ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Mbrotja lumore në urën e ShëMrizës

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45243510-0

VLERA E FONDIT LIMIT: me fond limit 83 067 864 (tetëdhjetë e tre milionë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe 99 681 437 (nëntëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë) lekë me tvsh.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gramsh** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023,2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontrates që do të prokurohet. . Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor."

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton" Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar pika 3.12 e tij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018** "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 9 i tij ku parashikohet: "Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet

për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministripërgjegjës për financat”.

Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojme që të kërkojme xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2022, 2023, 2024) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”*

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025** dhe kestet e maturuara për vitin **2026**, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Njësia e prokurimit kërkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (të ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

a) Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
- f. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9

Shenim: Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në

ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin:

Kategoritë e mëposhtme :

- | | | |
|---------|---|---|
| ➤ NP-1 | A | Punime germimi ne toke |
| ➤ NP-9 | C | Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime |
| ➤ NS-18 | A | Punime topogjeodezike |

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari

ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave të kerkuara janë bazuar në Lidhjen 2,3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

1. NP-1 A Punime germimi ne toke

Argumentimi – Pse kerkohet kjo licence-

Licenca **NP-1 A** është e domosdoshme pasi objekti përfshin punime të konsiderueshme gërmimi, transporti dhe formimi të trupit të mbrojtjes lumore. Këto punime përbëjnë fazën fillestare të realizimit të investimit dhe krijojnë bazën mbi të cilën ndërtohen të gjitha veprat e tjera.

Në këtë objekt, punimet nuk kufizohen vetëm në hapjen e gërmimeve, por përfshijnë edhe sistemimin e terrenit, largimin e materialit të tepërt, rrafshimin dhe ngjeshjen e sipërfaqeve, procese të cilat kërkojnë mjete të rënda, organizim teknik dhe eksperiencë në punime tokësore.

Nga preventivi rezultojnë:

- Germim dheu me eskavator **1,736.00 m³**.
- Transport dheu **1,736.00 m³**.
- Rrafshim dhe ngjeshje e dheut **15,467.58 m³**.
- Mbushje me zhavorr pas mureve **12,435.49 m³**.

Këto volume janë shumë të mëdha dhe tregojnë se pjesa kryesore e realizimit të objektit mbështetet në punime tokësore, të cilat mund të realizohen vetëm nga operatorë ekonomikë të pajisur me licencën **NP-1 A**.

Pa këto punime nuk mund të realizohen themelet, stabilizimi i terrenit dhe ndërtimi i veprave mbrojtëse.

2. NP-9 C Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime

Argumentimi – Pse kerkohet kjo licence-

Objekti ka si qëllim **mbrojtjen lumore në Urën e Shën Mrizës**, ç'ka e bën këtë licencë një kërkesë thelbësore.

Punimet nuk janë thjesht ndërtimore, por konsistojnë në ndërhyrje hidraulike për mbrojtjen e brigjeve nga erozioni, stabilizimin e shtratit të lumit dhe garantimin e funksionimit hidraulik të zonës.

Në preventiv janë parashikuar:

- Gabione $1 \times 1 \times 0.5$ m – **115 m³**.
- Gabione $1 \times 1 \times 1$ m – **42 m³**.
- Gabione $1 \times 1 \times 2$ m – **55 m³**.
- Gabione $1 \times 2 \times 2$ m – **125 m³**.
- Beton monolit – **980.96 m³**.

Gabionet janë elementët kryesorë të mbrojtjes së brigjeve dhe përdoren për disipimin e energjisë së rrjedhës, stabilizimin e skarpave dhe mbrojtjen nga gërryerja.

Ndërtimi i tyre kërkon njohuri të specializuara në hidraulikë dhe sistemime lumore, për këtë arsye realizimi i tyre lidhet drejtpërdrejt me licencën **NP-9 C**.

Kjo licencë garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin teknik për realizimin e veprave hidroteknike dhe të mbrojtjes lumore sipas standardeve.

3. NS-18 A Punime topogjeodezike

Argumentimi – Pse kerkohet kjo licence-

Punimet e mbrojtjes lumore kërkojnë saktësi të lartë në pozicionimin planimetrik dhe altimetrik të çdo elementi konstruktiv.

Në këtë objekt duhet të realizohen:

- piketimi i aksit të veprës;
- përcaktimi i kuotave të gjurmëve;
- kontrolli i thellësive;
- pozicionimi i gabioneve;
- kontrolli i niveleve të betonit;

- matjet për situacionet dhe kolaudimin.

Të gjitha zërat e preventivit realizohen mbi bazën e matjeve topografike, veçanërisht:

- gërmimet;
- rrafshimi dhe ngjeshja;
- mbushjet me zhavorr;
- gabionet;
- strukturat prej betoni.

Për shkak se edhe devijime të vogla në kuota ose pozicion mund të ndikojnë në funksionimin hidraulik dhe stabilitetin e veprës, prania e operatorit ekonomik të licencuar me **NP-18 A** është e nevojshme për garantimin e saktësisë së zbatimit dhe dokumentimit topografik gjatë gjithë procesit të ndërtimit.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------|---------|
| - Inxhinier Ndertimi | 1 (nje) |
| - Inxhinier Hidroteknik | 1 (nje) |
| - Inxhinier Gjeodet | 1 (një) |
| - Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |
| - Inxhinier Ndertimi Gjeoteknik | 1 (një) |

Per kete operatoret ekonomikduhet te paraqesin :

Kontrate pune,Diplomen universitare,Libreze pune ,Cv

Drejtuesi teknik duhet t e jete punesuar sipas kriterëve te VKM nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar sa i takon dy punesimit.

N e cdo rast autoriteti kontrakt ka te drejte te beje verifikime lidhur me deklarimin e OE, ne funksion te permbushjes se ketij kriterë .

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetdeklarimi ,sipas shtojces 8 te DST.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë

përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për Inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i Inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

1. Inxhinier Ndertimi 1 (nje)

Argumentimi

Ky është inxhinieri përgjegjës për organizimin dhe drejtimin teknik të punimeve civile. Kërkesa për **1 (një) Inxhinier Ndërtimi** është plotësisht e justifikuar nga natyra dhe përmasat e punimeve të parashikuara në preventiv. Ky specialist është përgjegjësi teknik kryesor për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punimeve civile, duke garantuar që ato të realizohen në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet e zbatimit.

Objekti përfshin një sërë procesesh ndërtimore që zhvillohen në vazhdimësi dhe që kërkojnë mbikëqyrje të përhershme teknike. Punimet fillojnë me **gërmimin e 1,736 m³ dheu**, i cili duhet të realizohet sipas dimensioneve, kuotave dhe pjerrësive të projektit. Gjatë kësaj faze, Inxhinieri i Ndërtimit kontrollon kufijtë e gërmimeve, stabilitetin e skarpave, organizimin e punës së makinerive dhe zbatimin korrekt të projektit.

Pas përfundimit të gërmimeve, preventivi parashikon **transportin e 1,736 m³ materiali, rrafshimin dhe ngjeshjen e 15,467.58 m³ dheu**, si dhe **mbushjen me 12,435.49 m³ zhavorr**. Këto janë procese që ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e veprës dhe kërkojnë kontroll të vazhdueshëm mbi mënyrën e vendosjes së materialeve, trashësinë e shtresave, ngjeshjen dhe respektimin e parametrave teknikë të projektit.

Një pjesë shumë e rëndësishme e objektit është ndërtimi i **gabioneve**, të cilat realizohen në disa dimensione dhe me një volum total prej **337 m³**. Gjatë kësaj faze, Inxhinieri i Ndërtimit kontrollon përgatitjen e bazamentit, montimin e rrjetave metalike, mbushjen me gur sipas specifikimeve teknike, lidhjen ndërmjet elementëve dhe respektimin e gjeometrisë së projektit. Cilësia e realizimit të gabioneve ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e mbrojtjes lumore

Po kështu, preventivi përfshin **26.212 ton hekur betoni dhe 980.96 m³ beton monolit**, punime që kërkojnë kontroll të vazhdueshëm mbi armaturën, kallëpet, hedhjen e betonit, vibrimin, kurimin dhe respektimin e kërkesave teknike për rezistencën e strukturës.

Pse kerkohet vetem 1 (nje)

Megjithëse objekti përfshin disa kategori punimesh, ai zhvillohet në një objekt të vetëm dhe nuk paraqet disa fronte të pavarura pune që të justifikojnë praninë e më shumë se një Inxhinieri Ndërtimi. Për këtë arsye, kërkesa për **1 (një) Inxhinier Ndërtimi** është proporcionale me përmasat dhe kompleksitetin e objektit, duke garantuar drejtimin teknik të punimeve.

2. Inxhinier Ndërtimi Gjeoteknik 1 (nje)

Kërkesa për **1 (një) Inxhinier Ndërtimi Gjeoteknik** është përcaktuar në funksion të natyrës së punimeve, volumeve të preventivit dhe kompleksitetit teknik të objektit, i cili përfshin gërmime, mbushje, ndërtimin e gabioneve, formimin e trupit të digës dhe realizimin e strukturave prej betoni të armuar.

Inxhinieri Ndërtimi Gjeoteknik është përgjegjës për kontrollin e kushteve gjeoteknike të terrenit, vlerësimin e stabilitetit të gërmimeve, kontrollin e mbushjeve dhe ngjeshjes së tyre, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e veprës.

Ky specialist lidhet drejtpërdrejt me realizimin e zërave të mëposhtëm të preventivit:

- ✚ **Gërmim dhe me eskavator – 1,736 m³**, për kontrollin e stabilitetit të gërmimeve dhe respektimin e kuotave të projektit.
- ✚ **Rrafshim dhe ngjeshje dhe në trup dige – 15,467.58 m²**, për verifikimin e mënyrës së vendosjes dhe ngjeshjes së shtresave të dheut.
- ✚ **Mbushje me zhavorr pas mureve – 12,435.49 m³**, për kontrollin e cilësisë së materialit, trashësisë së shtresave dhe parametrave të ngjeshjes.
- ✚ **Gabione me rrjeta teli të zingëra 337 m³**, për kontrollin e përgatitjes së bazamentit dhe stabilitetit të strukturave mbajtëse.
- ✚ **Struktura monolite betoni C16/20 – 980.96 m³**, për verifikimin e kushteve të bazamentit mbi të cilin realizohen strukturat.

Gjatë gjithë periudhës **6-mujore** të zbatimit të kontratës, Inxhinieri Ndërtimi Gjeoteknik do të ndjekë proceset e gërmimeve, mbushjeve dhe ngjeshjes, duke kontrolluar që punimet të realizohen sipas projektit, specifikimeve teknike dhe kushteve gjeoteknike të terrenit, në mënyrë që të garantohet stabiliteti dhe jetëgjatësia e veprës.

Për rrjedhojë, kërkesa për **1 (një) Inxhinier Ndërtimi Gjeoteknik** është teknikisht e argumentuar, proporcionale me objektin dhe e domosdoshme për garantimin e zbatimit korrekt të punimeve që ndikojnë në stabilitetin gjeoteknik të objektit, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe standardet e ndërtimit.

3. Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)

Argumentimi

Ky është një nga inxhinierët më të rëndësishëm të këtij objekti. Vetë objekti është mbrojtje lumore.

Kërkesa për **1 (një) Inxhinier Hidroteknik** është plotësisht e justifikuar dhe në përputhje me natyrën e objektit, pasi investimi ka për objekt **mbrojtjen lumore në Urën e Shën Mrizës**, ku qëllimi kryesor është stabilizimi i brigjeve dhe garantimi i funksionimit të sigurt të veprës përballë prurjeve të lumit. Në një objekt të tillë, Inxhinieri Hidroteknik është specialisti përgjegjës për kontrollin teknik të të gjitha punimeve që ndikojnë në regjimin hidraulik të rrjedhës dhe në funksionimin afatgjatë të veprës.

Punimet e parashikuara në preventiv nuk janë thjesht punime civile, por përfaqësojnë ndërhyrje të drejtpërdrejta në shtratin dhe brigjet e lumit. Për këtë arsye, gjatë fazës së gërmimeve prej **1,736 m³**, Inxhinieri Hidroteknik kontrollon që gërmimet të realizohen sipas kuotave dhe profileve të projektit, në mënyrë që të mos ndryshohet seksioni hidraulik i lumit dhe të mos krijohen pengesa ose devijime të rrjedhës së ujit.

Një nga elementët kryesorë të objektit është ndërtimi i **gabioneve**, me një volum total prej **337 m³**, të shpërndarë në disa dimensione. Gabionet përbëjnë vetë strukturën mbrojtëse të brigjeve dhe janë elementi që përballon veprimin e ujit, presionin hidraulik dhe proceset e gërryerjes. Inxhinieri Hidroteknik kontrollon përgatitjen e bazamentit, pozicionimin e tyre sipas projektit, lidhjen ndërmjet elementëve, mënyrën e mbushjes me gur dhe vazhdimësinë e strukturës, duke garantuar që mbrojtja lumore të funksionojë sipas projektimit dhe të mos krijohen pika dobësie gjatë prurjeve të larta.

Preventivi parashikon gjithashtu **12,435.40 m³ mbushje me zhavorr**, të cilat kanë rol të rëndësishëm në stabilizimin e pasëm të strukturave mbrojtëse dhe në shmangien e grumbullimit të ujërave pas gabioneve. Inxhinieri Hidroteknik kontrollon që mbushjet të realizohen me materialin e specifikuar, sipas trashësive dhe kuotave të projektit, pasi çdo devijim mund të ndikojë në stabilitetin e veprës dhe në sjelljen e saj gjatë prurjeve.

Po ashtu, objekti përfshin **980.96 m³ beton monolit**, i cili përbën pjesë të rëndësishme të veprës mbrojtëse. Inxhinieri Hidroteknik verifikon që elementët prej betoni të ndërtohen sipas dimensioneve dhe kuotave të projektit hidroteknik, në mënyrë që të mos ndryshojnë karakteristikat hidraulike të veprës dhe të sigurohet rezistenca ndaj veprimit të ujit.

Gjatë gjithë zbatimit të veprës, Inxhinieri Hidroteknik bashkëpunon me Inxhinierin e Ndërtimit dhe Inxhinierin Gjeodet për kontrollin e kuotave, profileve tërthore dhe gjatësore, verifikimin e pozicionit të strukturave dhe respektimin e parametrave hidraulikë të projektit. Ai është përgjegjës për të evidentuar dhe korrigjuar çdo devijim që mund të ndikojë në funksionimin e mbrojtjes lumore ose të rrisë rrezikun e erozionit dhe dëmtimit të brigjeve.

Për shkak se objekti është një vepër hidroteknike dhe funksionimi i saj lidhet drejtpërdrejt me sjelljen e rrjedhës së lumit, prania e **1 (një) Inxhinieri Hidroteknik** gjatë zbatimit të punimeve është plotësisht e domosdoshme dhe proporcionale. Kërkesa për një specialist të vetëm është e mjaftueshme, pasi objekti zhvillohet në një front pune dhe nuk paraqet kompleksitet të tillë që të kërkojë më shumë se një Inxhinier Hidroteknik.

4. Inxhinier Gjeodet 1 (nje)

Argumentimi

Objekti nuk mund të zbatohet pa matje topografike. Kërkesa për **1 (një) Inxhinier Gjeodet** është plotësisht e justifikuar dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv. Punimet e mbrojtjes lumore kërkojnë saktësi të lartë planimetrike dhe altimetrike, pasi çdo devijim në pozicion ose në kuotë mund të ndikojë në stabilitetin e veprës, funksionimin hidraulik dhe përputhshmërinë me projektin e miratuar.

Inxhinieri Gjeodet është specialisti përgjegjës për të gjitha matjet topografike gjatë fazës së zbatimit të veprës. Ai realizon piketimin fillestar të objektit, përcakton aksin e veprës, kufijtë e punimeve, kuotat e projektit dhe pikat fikse të referimit, mbi të cilat mbështetet zbatimi i çdo zëri të preventivit.

Punimet fillojnë me **gërmimin e 1,736 m³ dheu**, ku Inxhinieri Gjeodet përcakton kufijtë e gërmimit, kontrollon thellësitë dhe kuotat e projektuara dhe verifikon që gërmimet të mos dalin jashtë profileve të miratuara. Në një objekt mbrojtjeje lumore, edhe devijime të vogla në kuota mund të ndikojnë në funksionimin e veprës dhe në regjimin e rrjedhës së ujit

Gjatë realizimit të **rrafshimit dhe ngjeshjes së 15,467.58 m³**, si dhe të **mbushjes me 12,435.49 m³ zhavorr**, Inxhinieri Gjeodet kontrollon vazhdimisht kuotat përfundimtare, pjerrësitë dhe trashësitë e shtresave sipas projektit. Ky kontroll është i domosdoshëm për të garantuar që mbushjet dhe formimi i terrenit të realizohen sipas parametrave teknikë dhe të mos krijohen deformime ose diferenca nivelesh që mund të ndikojnë në stabilitetin e strukturës.

Një rol veçanërisht të rëndësishëm ka gjatë ndërtimit të **gabioneve**, me volum total **337 m³**, ku kontrollon pozicionimin planimetrik dhe altimetrik të çdo elementi, shtrirjen sipas aksit të projektit, vijueshmërinë e strukturës dhe respektimin e dimensioneve të parashikuara. Pozicionimi i gabuar i gabioneve mund të ndryshojë seksionin e mbrojtjes, të ulë eficiencën e saj dhe të krijojë pika të dobëta ndaj veprimit të rrjedhës së lumit.

Gjithashtu, gjatë realizimit të **980.96 m³ beton monolit**, Inxhinieri Gjeodet kontrollon kuotat e themeleve, nivelin e elementëve të betonit dhe pozicionin e tyre në raport me projektin. Saktësia e këtyre matjeve është thelbësore për funksionimin korrekt të strukturës dhe për lidhjen e saj me elementët e tjerë të mbrojtjes lumore.

Përveç kontrollit gjatë zbatimit, Inxhinieri Gjeodet kryen matjet për situacionet mujore të punimeve, verifikon saktësi faktike të realizuara dhe përgatit dokumentacionin topografik që shërben si bazë për certifikimin e punimeve dhe kolaudimin e objektit. Prania e tij garanton që saktësi të preventivit të realizohen sipas projektit dhe të dokumentohen me saktësi.

Pse kerkohet vetem 1 (nje)

Objekti zhvillohet në një segment të vetëm dhe nuk përfshin disa fronte të ndara pune që të kërkojnë ekipe të shumta topografike. Të gjitha matjet, piketimet dhe verifikimet mund të mbulohen në mënyrë të plotë nga **1 (një) Inxhinier Gjeodet**, i cili siguron kontrollin topografik gjatë gjithë ciklit të zbatimit të punimeve. Për këtë arsye, kërkesa për **1 (një) Inxhinier Gjeodet** është teknike, proporcionale dhe plotësisht e lidhur me natyrën e punimeve të preventivit.

5. Inxhinier Gjeolog 1 (nje)

Kërkesa për **1 (një) Inxhinier Gjeolog** është përcaktuar në funksion të natyrës së objektit, i cili përfshin punime gërmimi, mbushjeje, ndërtimin e gabioneve, formimin e trupit të digës dhe realizimin e strukturave prej betoni, si dhe në përputhje me faktin që dokumentacioni teknik i projektit përmban **Raport Gjeologjik**, rekomandimet e të cilit duhet të zbatohen dhe të monitorohen gjatë realizimit të punimeve.

Inxhinieri Gjeolog është përgjegjës për interpretimin e kushteve gjeologjike të terrenit, verifikimin e përputhshmërisë së tyre me parashikimet e raportit gjeologjik, identifikimin e ndryshimeve të mundshme gjatë gërmimeve dhe dhënien e rekomandimeve teknike për zbatimin e sigurt të punimeve.

Ky specialist lidhet drejtpërdrejt me realizimin e zërave të mëposhtëm të preventivit:

- ✚ **Gërmim dheu me eskavator – 1,736 m³**, për verifikimin e kushteve gjeologjike të terrenit gjatë hapjes së kanalit;
- ✚ **Rrafshim dhe ngjeshje dheu në trup dige – 15,467.58 m²**, për kontrollin e karakteristikave të shtresave natyrore dhe të mbushjeve;
- ✚ **Mbushje me zhavorr pas mureve – 12,435.49 m³**, për verifikimin e përshtatshmërisë së bazamentit dhe kushteve të kontaktit me terrenin natyror;
- ✚ **Gabione – 337.00 m³**, për kontrollin e kushteve të themelimit dhe stabilitetit të terrenit;
- ✚ **Struktura monolite betoni C16/20 – 980.96 m³**, për verifikimin e bazamentit mbi të cilin mbështeten strukturat.

Gjatë gjithë periudhës **6-mujore** të zbatimit të investimit, Inxhinieri Gjeolog do të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të raportit gjeologjik, do të verifikojë përputhshmërinë e kushteve reale të terrenit me dokumentacionin teknik dhe do të propozojë masat teknike të nevojshme në rast të evidentimit të kushteve gjeologjike të paparashikuara, duke garantuar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e veprës.

Për rrjedhojë, kërkesa për **1 (një) Inxhinier Gjeolog** është teknikisht e argumentuar, proporcionale me objektin dhe e domosdoshme për zbatimin e rekomandimeve të raportit gjeologjik dhe garantimin e realizimit të punimeve sipas dokumentacionit teknik.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

a. (Një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumine datën e hapjes së tenderit. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej*

Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"), ose kontratë shërbimi me subjekte private të licensuara për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" ku citohet..... *"Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion".*

Specialisti për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë harton planin e sigurisë dhe të koordinimit në kanton, parapërgatit një dosje, e cila përmban informacionet e nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar punëtorët, hartojnë planin operativ të sigurisë, kryejnë mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve.

Në rregulloren për sigurinë në kanton miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantonin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, në datën e fundit të hapjes së ofertave si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Teknik Topograf
- 1 (një) Teknik Hidroteknik
- 8 (tete) Punonjës Karpentierë
- 6 (gjashtë) Punonjës Betonues
- 3 (tre) Punonjës Muratorë
- 6 (gjashtë) Punonjës Gurepunues

- 5 (pese) Punonjes Hekurkthyes
- 3 (tre) Punonjes Eskavatorist
- 2 (dy) Punonjes Automakinist
- 2 (dy) Punonjes Buldozerist
- 3 (tre) shofere

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Nr Amzes
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.
- Per tekniket te paraqitet diploma e shkolles se mesme/diplome bachelor

Për punonjësit manovratorët-shoferet, ofertuesi duhet të paraqesë:

a) kontratë individuale të punës;

b) leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët-shoferet, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Në rastin kur punonjësit manovratorët-shoferet janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit **Profesional**.

1. Teknik Ndërtimi 1 (nje)

Argumentimi

Kërkesa për **1 (një) Teknik Ndërtimi** është plotësisht e justifikuar dhe proporcionale me natyrën dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv. Ky punonjës përbën mbështetjen teknike të drejtpërdrejtë të Inxhinierit të Ndërtimit dhe siguron ndjekjen e përditshme të proceseve të zbatimit në kantier.

Objekti përfshin një numër të konsiderueshëm punimesh civile, duke filluar nga **1,736 m³ gërmime, 15,467.58 m³ rrafshim dhe ngjeshje, 12,435.49 m³ mbushje me zhavorr, 337 m³ gabione, 26.212 ton hekur betoni** dhe rreth **1,957.78 m³ punime betoni** (980.96 m³ strukturë monolite dhe 976.82 m³ shtresë betoni C12/15).

Gjatë zbatimit të këtyre punimeve, Tekniku i Ndërtimit kontrollon zbatimin praktik të detyrave të lëna nga Inxhinieri i Ndërtimit, ndjek organizimin e grupeve të punës, verifikon respektimin e dimensioneve dhe niveleve të punimeve, kontrollon cilësinë vizuale të punimeve dhe evidenton problematikat teknike që kërkojnë ndërhyrjen e inxhinierit.

Ai asiston në matjen e punimeve të realizuara, ndjek përdorimin e materialeve në kantier, organizimin e kallëpeve, armaturës dhe betonimeve, si dhe koordinon punën ndërmjet brigadave të ndryshme.

Prania e tij është e nevojshme për të siguruar kontroll të vazhdueshëm teknik gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës.

Pse kerkohet 1 (nje)

Objekti zhvillohet në një kantier të vetëm dhe nuk ka disa fronte të ndara pune që të kërkojnë më shumë se një Teknik Ndërtimi. Për këtë arsye, **1 (një)** Teknik Ndërtimi është numër i mjaftueshëm dhe proporcional.

2. Teknik Topograf 1 (nje)

Argumentimi

Kërkesa për **1 (një) Teknik Topograf** është e justifikuar dhe përbën mbështetje të drejtpërdrejtë për Inxhinierin Gjeodet gjatë zbatimit të punimeve. Duke qenë se objekti përfshin punime lineare dhe ndërhyrje në shtratin e lumit, kontrolli i vazhdueshëm topografik është i domosdoshëm.

Tekniku Topograf asiston në piketimin e aksit të veprës, vendosjen e kuotave të gërmimeve, kontrollin e profileve gjatësore dhe tërthore, verifikimin e pozicionit të gabioneve, matjen e volumeve të gërmimeve, mbushjeve dhe betonimeve, si dhe përgatitjen e situacioneve të punimeve.

Ai lidhet drejtpërdrejt me:

- 1,736 m³ gërmime;
- 15,467.58 m³ rrafshim dhe ngjeshje;
- 12,435.49 m³ mbushje;
- 337 m³ gabione;
- 1,957.78 m³ beton.

Për një objekt të vetëm, **1 Teknik Topograf** është numër i mjaftueshëm.

3. Teknik Hidroteknik 1 (nje)

Argumentimi

Kërkesa për **1 (një) Teknik Hidroteknik** është e justifikuar, pasi objekti është një vepër mbrojtjeje lumore dhe kërkon ndjekje të vazhdueshme të punimeve hidroteknike në terren.

Tekniku Hidroteknik asiston Inxhinierin Hidroteknik në kontrollin e kuotave të projektit, vendosjen e gabioneve, kontrollin e mbushjeve me zhavorr pas strukturave mbrojtëse, kontrollin e betonimeve dhe evidentimin e problematikave që lidhen me rrjedhën e ujit gjatë punimeve.

Ai lidhet kryesisht me:

- 337 m³ gabione;
- 12,435.49 m³ mbushje;
- 1,957.78 m³ beton.

Përmasat e objektit justifikojnë **1 Teknik Hidroteknik**.

4. Punonjes Karpentier 8 (tete)

Argumentimi

Preventivi përfshin rreth **1,957.78 m³ punime betoni**, të ndara në:

- 980.96 m³ strukturë monolite;
- 976.82 m³ shtresë betoni C12/15.

Pjesa e strukturave monolite kërkon kallëpe për themele, elementë mbajtës dhe struktura betoni. Punimet e kallëpeve duhet të kryhen paralelisht me armimin dhe betonimin për të mos ndërprerë ritmin e punimeve.

Megjithatë, **shtresa e betonit C12/15 zakonisht nuk kërkon të njëjtin volum kallëpesh si strukturat monolite**, pasi në shumë raste realizohet mbi sipërfaqe të përgatitura.

Për këtë arsye, **8 karpentierë mund të konsiderohen të justifikueshëm**.

5. Punonjes Betonues 6 (gjashte)

Argumentimi

Ky numër është plotësisht i justifikuar.

Rreth **1,957.78 m³ beton** kërkojnë organizim të mirë të hedhjes, vibrimit, nivelimit dhe kurimit të betonit.

Punonjësit betonues kryejnë:

- përgatitjen e frontit të betonimit;
- shpërndarjen e betonit;
- vibrimin;
- nivelimin;
- përfundimin e sipërfaqeve;
- mbrojtjen dhe kurimin e betonit.

Për të garantuar vazhdimësinë e betonimeve, **6 betonues janë plotësisht të arsyeshëm**.

6. Punonjes Muratore 3 (tre)

Argumentimi

Kërkesa për disponimin e **3 (tre) punonjësve muratorë** është plotësisht e justifikuar nga natyra dhe përmasat e punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë ndërtimin e veprave hidroteknike dhe mbrojtëse me gabione, punime betoni dhe betonarmeje.

Punonjësit muratorë janë të domosdoshëm për realizimin e punimeve që kërkojnë vendosje, sistemim dhe përpunim manual me saktësi të lartë, punime të cilat nuk mund të realizohen vetëm me makineri ose nga punonjës të profesioneve të tjera.

Në këtë objekt, muratorët angazhohen drejtpërdrejt në:

- **Montimin dhe formësimin e gabioneve**, duke realizuar hapjen, montimin, lidhjen dhe stabilizimin e koshave metalikë sipas dimensioneve të projektit, si dhe kontrollin e pozicionimit të tyre para mbushjes me gurë. Preventivi parashikon një sasi të konsiderueshme gabionesh me dimensione të ndryshme (1x1x0.5 m, 1x1x1 m, 1x1x2 m dhe 1x2x2 m), çka kërkon punë manuale të vazhdueshme dhe të specializuara.
- **Sistemimin manual të gurëve brenda gabioneve**, duke siguruar shpërndarjen uniforme të tyre, vendosjen e gurëve më të mëdhenj në faqet e dukshme, mbushjen e boshllëqeve dhe garantimin e kompaktësisë e stabilitetit të strukturës. Kjo fazë nuk realizohet me mjete mekanike dhe kërkon punë të kualifikuara
- **Përgatitjen dhe rregullimin e bazamentit të gabioneve**, nivelimin lokal, korrigjimin e sipërfaqeve dhe përshtatjen e elementëve gjatë vendosjes, në mënyrë që veprat të ndërtohen sipas kuotave dhe dimensioneve të projektit
- **Punimet ndihmëse në elementët e betonit dhe betonarmesë**, përfshirë mbylljen e fugave, rregullimin e sipërfaqeve të betonit pas betonimit, riparimet lokale, mbushjet manuale dhe përfundimet që kërkojnë gjatë realizimit të strukturave të betonit. Preventivi përfshin rreth **980.96 m³ beton** dhe mbi **26 ton hekur betoni**, çka shoqërohet domosdoshmërisht me punime manuale të përfundimit.
- **Mbushjen me zhavorr pas mureve dhe sistemimin manual të materialit** në zonat ku makineritë nuk kanë akses ose ku kërkohet punim me kujdes për të mos dëmtuar strukturat e ndërtuara.

Përmasat e objektit, sasia e konsiderueshme e punimeve me gabione, beton dhe betonarme, si dhe nevoja për zhvillimin paralel të proceseve të punës në disa fronte, e bëjnë të domosdoshme praninë e **minimumi 3 (tre) punonjësve muratorë**. Ky numër siguron ritmin normal të zbatimit të vepres, cilësinë e punimeve, respektimin e specifikimeve teknike dhe përmbushjen e afateve të realizimit të investimit..

7. Punonjes Gurepunues 6 (gjashte)

Argumentimi

Ky numër është plotësisht i justifikuar.

Objekti përfshin **337 m³ gabione**, të cilat mbushen me gurë të përzgjedhur sipas specifikimeve teknike.

Gurepunuesit kryejnë:

- përzgjedhjen e gurëve;
- sistemimin manual;
- mbushjen e gabioneve;
- eliminimin e boshllëqeve;
- formimin e faqeve të ekspozuara.

Punimet janë intensive dhe realizohen kryesisht me dorë.

6 gurepunues janë plotësisht të justifikuar.

8. Punonjes Hekurkthyes 5 (pese)

Argumentimi

Kërkesa për disponimin e **5 (pesë) punonjësve hekurkthyes** është plotësisht e justifikuar nga natyra, përmasat dhe kompleksiteti i punimeve të parashikuara në preventiv. Objekti përfshin realizimin e strukturave të betonarmesë, të cilat kërkojnë përpunim, prerje, përkulje, montim dhe lidhje profesionale të armaturës së çelikut përpara procesit të betonimit.

Preventivi parashikon furnizimin dhe vendosjen e **hekurit të zakonshëm të betonit Ø6–10 mm dhe Ø9–12 mm**, në një sasi totale prej rreth **26.2 ton armaturë** (20.012 ton + 6.2 ton). Kjo përfaqëson një volum të konsiderueshëm pune, i cili kërkon staf të specializuar për përpunimin dhe montimin korrekt të armaturës.

Punonjësit hekurkthyes janë të domosdoshëm për:

- **Prerjen dhe përkuljen e shufrave të armaturës** sipas dimensioneve dhe formave të përcaktuara në projektin konstruktiv.
- **Montimin dhe lidhjen e kafazeve të armaturës**, duke siguruar distancat, mbivendosjet dhe lidhjet sipas specifikimeve teknike dhe normave të zbatimit.
- **Vendosjen e armaturës në elementët e betonarmesë**, duke garantuar pozicionimin e saktë përpara betonimit dhe ruajtjen e mbulesës mbrojtëse të betonit.
- **Kontrollin dhe korrigjimin e armaturës** gjatë vendosjes së kallëpeve dhe para hedhjes së betonit, për të shmangur deformimet ose lëvizjet që mund të cenojnë rezistencën e strukturës.
- **Bashkëpunimin me ekipin e karpentierëve dhe betonuesve**, në mënyrë që procesi i montimit të armaturës dhe betonimit të zhvillohet pa ndërprerje dhe sipas grafikut të punimeve.

Gjithashtu, objekti përfshin realizimin e **rreth 980.96 m³ strukturash betony dhe 976.82 m³ shtrese betoni C12/15**, të cilat nuk mund të ekzekutohen pa përfundimin paraprak të montimit të armaturës. Për këtë arsye, hekurkthyesit përbëjnë një hallkë thelbësore në zinxhirin teknologjik të punimeve të betonarmesë.

Duke marrë në konsideratë sasinë e konsiderueshme të armaturës, volumin e madh të betonarmesë, nevojën për zhvillimin paralel të punimeve në disa fronte dhe respektimin e afateve, kërkesa për **minimumi 5 (pesë) punonjës hekurkthyes** është proporcionale, e arsyeshme dhe teknikisht e domosdoshme për realizimin me cilësi dhe brenda afatit të objektit.

9. Punonjes Eskavatoris 3 (tre)

Argumentimi

Kërkesa për disponimin e **3 (tre) punonjësve eskavatoristë** është plotësisht e justifikuar nga natyra dhe volumi i punimeve të parashikuara në preventiv, si dhe nga pajisjet mekanike të nevojshme për realizimin e tyre. Për zbatimin e objektit janë parashikuar **mjete gërmuese**, konkretisht **eskavator me zinxhir, eskavator me goma dhe mini-eskavator**, të cilët kryejnë procese pune të ndryshme dhe shpesh zhvillohen paralelisht në kantier.

Punimet e preventivit përfshijnë një volum të konsiderueshëm gërmimesh dhe sistemimesh, ku janë parashikuar **1,736 m³ gërmim dheu me eskavator**, si dhe transporti dhe sistemimi i materialit të gërmuar, punime që realizohen kryesisht me mjete mekanike. Gjithashtu, objekti përfshin vendosjen e gabioneve dhe realizimin e strukturave të betonit, procese që kërkojnë përdorimin e vazhdueshëm të eskavatorëve për përgatitjen e bazamentit, lëvizjen e materialeve dhe asistimin gjatë montimit të elementëve.

Eskavatoristët janë të domosdoshëm për:

- Operimin e **eskavatorit me zinxhir**, i cili përdoret për gërmime në terrene të vështira, formimin e bazamentit të veprave mbrojtëse, sistemimin e shtratit të lumit dhe ngarkimin e materialeve.
- Operimin e **eskavatorit me goma**, i cili shërben për gërmime, ngarkim materialeve dhe lëvizje të shpejtë ndërmjet fronteve të punës, duke garantuar vazhdimësinë e procesit të ndërtimit.
- Operimin e **mini-eskavatorit**, i cili është i domosdoshëm për punime në hapësira të kufizuara, pranë strukturave ekzistuese, gjatë sistemimit të bazamenteve të gabioneve, punimeve të imëta të profilimit dhe pastrimit të zonave ku eskavatorët e mëdhenj nuk mund të operojnë.

Përveç gërmimeve, këta operatorë kryejnë edhe **profilimin e terrenit, sistemimin e materialeve, ngarkimin dhe shkarkimin e gurëve për gabionet, mbushjet lokale dhe asistimin mekanik gjatë realizimit të strukturave të betonit dhe betonarmesë**, duke siguruar zhvillimin normal të punimeve në të gjitha fazat e zbatimit.

Duke qenë se në objekt janë parashikuar **mjete gërmuese**, secili prej të cilëve kërkon operator të dedikuar për arsye sigurie, efikasiteti dhe respektimi të legjislacionit për shëndetin dhe sigurinë në punë, kërkesa për **minimumi 3 (tre) punonjës eskavatoristë** është plotësisht proporcionale me nevojat e investimit. Ky numër garanton funksionimin e pandërprerë të pajisjeve, zhvillimin paralel të fronteve të punës dhe përmbushjen e afateve të zbatimit të investimit.

10. Punonjes Automakinist 2 (dy)

Argumentimi

Kërkesa për disponimin e **2 (dy) punonjësve automakinistë** është e justifikuar nga natyra e punimeve dhe nevoja për transportin e vazhdueshëm të materialeve, pajisjeve dhe elementëve të ndërtimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Për realizimin e objektit janë parashikuar

kamionë vetëshkarkues me tonazh të ndryshëm, kamion me vinç dhe kamionçinë, mjete të domosdoshme për zhvillimin normal të proceseve të punës.

Preventivi parashikon një volum të konsiderueshëm gërmimesh, transport dhe lëvizje materiale, përfshirë **1,736 m³ gërmime, 1,736 m³ transport dheu**, si dhe transportin dhe furnizimin e sasive të mëdha të gurëve për gabione, zhavorrit, armaturës dhe betonit, çka kërkon përdorimin e vazhdueshëm të mjeteve të transportit.

Punonjësit automakinistë janë të domosdoshëm për:

- Operimin e **kamionëve vetëshkarkues**, të cilët realizojnë transportin e materialit të gërmuar, zhavorrit, gurëve për gabione dhe materialeve të tjera ndërtimore nga vendet e furnizimit deri në kantier dhe anasjelltas.
- Operimin e **kamionit me vinç**, i cili përdoret për ngarkimin, shkarkimin dhe pozicionimin e elementëve të rëndë, materialeve të ndërtimit, armaturës, kallëpeve, gabioneve dhe pajisjeve të kantierit në zonat e punës.
- Operimin e **kamionçinës**, e cila shërben për transportin e materialeve ndihmëse, veglave të punës, pajisjeve të vogla, si dhe për furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të ndryshme të punës.

Për shkak se punimet zhvillohen në disa procese njëkohësisht, transporti i materialeve duhet të jetë i pandërprerë për të mos krijuar vonesa në gërmime, ndërtimin e gabioneve, punimet e betonit dhe betonarmesë. Prandaj, disponimi i automakinistëve siguron koordinimin e transportit dhe furnizimin në kohë të çdo fronti pune.

Duke qenë se objekti kërkon përdorimin e disa mjeteve të transportit me funksione të ndryshme dhe me ngarkesë të lartë pune gjatë gjithë zbatimit të investimit, kërkesa për **minimumi 2 (dy) punonjës automakinistë** është proporcionale, e arsyeshme dhe teknikisht e domosdoshme. Ky numër garanton operimin e mjeteve kryesore të transportit, vazhdimësinë e proceseve të punës dhe përmbushjen e objektivave të kontratës brenda afateve të përcaktuara.

11. Punonjes Buldozerist 1 (nje)

Argumentimi

Kërkesa për disponimin e **1 (një) punonjësi buldozerist** është plotësisht e justifikuar nga natyra dhe volumi i punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime të konsiderueshme gërmimi, sistemimi dhe profilimi të terrenit, si dhe formimin e trupit të digës dhe bazamenteve të veprave mbrojtëse.

Preventivi parashikon **1,736 m³ gërmime dheu me eskavator, 1,736 m³ transport të materialit të gërmuar**, si dhe **15,467.5 m³ rrafshim dhe ngjeshje dheu në trup dige**, volum i konsiderueshëm që kërkon domosdoshmërisht përdorimin e buldozerit për shpërndarjen, sistemimin dhe profilimin e materialit.

Buldozeristi është operatori përgjegjës për drejtimin dhe operimin e buldozerit, i cili në këtë objekt kryen funksione thelbësore si:

- shpërndarjen dhe sistemimin e materialit të gërmuar në zonat e mbushjes;
- profilimin dhe nivelimin e sipërfaqeve sipas kuotave të projektit;
- formimin e trupit të digës dhe përgatitjen e sipërfaqeve për ngjeshje ;
- pastrimin dhe përgatitjen e platformave të punës për ndërtimin e gabioneve;
- krijimin e bazamenteve të qëndrueshme për vendosjen e strukturave mbrojtëse;
- sistemimin e materialeve në kantier dhe mbështetjen e proceseve të tjera mekanike gjatë gjithë zbatimit të punimeve.

Gjithashtu, realizimi i veprave me gabione kërkon bazamente të niveluara dhe të profiluara me saktësi përpara montimit dhe mbushjes së tyre me gurë. Për këtë arsye, buldozeri përbën një mjet mbështetës të domosdoshëm gjatë ndërtimit të mbrojtjes lumore.

Për shkak të volumit të madh të punimeve të tokës, nevojës për zhvillimin e pandërprerë të proceseve të sistemimit dhe profilimit të terrenit, si dhe bashkërendimit me eskavatorët, kamionët dhe cilindrin ngjeshës, disponimi i **1 (një) punonjësi buldozerist** është plotësisht proporcional me objektin e investimit dhe teknikut të domosdoshëm për realizimin e punimeve me cilësinë e kërkuar dhe brenda afateve.

12. Shofere 3 (tre)

Argumentimi

Kërkesa për disponimin e **3 (tre) shoferëve** është plotësisht e justifikuar nga natyra, volumi dhe organizimi i punimeve të parashikuara në preventiv, i cili përfshin punime të konsiderueshme gërmimi, transporti, ndërtimi të gabioneve dhe punime betoni e betonarmeje. Këto procese kërkojnë furnizim dhe transport të pandërprerë të materialeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të vepres.

Në zbatim të punimeve janë parashikuar mjete të ndryshme transporti, si **kamionë vetëshkarkues me tonazh të ndryshëm, kamion me vinç dhe kamionçinë**, të cilat përdoren për transportin e materialeve, pajisjeve dhe elementëve ndërtimorë në funksion të realizimit të objektit.

Shoferët janë të domosdoshëm për:

- transportin e materialit të gërmuar dhe materialeve inerte në funksion të punimeve të gërmimit dhe sistemimit të terrenit;
- transportin e gurëve për mbushjen e gabioneve, të zhavorrit dhe materialeve të tjera ndërtimore në frontet e punës;
- transportin e hekurit të betonit, materialeve për betonim dhe pajisjeve ndihmëse të kantierit;
- operimin e kamionit me vinç për ngarkimin, shkarkimin dhe lëvizjen e materialeve të rënda dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e punimeve;
- furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës me materiale dhe pajisje, duke shmangur ndërprerjet e proceseve të ndërtimit.

Volumi i punimeve, që përfshin **1,736 m³ gërmime, 1,736 m³ transport të materialit të gërmuar, mbi 15,467 m³ punime sistemimi dhe ngjeshjeje**, si dhe ndërtimin e gabioneve dhe strukturave të betonit e

betonarmesë, gjeneron një fluks të vazhdueshëm transporti gjatë gjithë periudhës së zbatimit të investimit.

Për këtë arsye, disponimi i **3 (tre) shoferëve** është proporcional me numrin dhe llojin e mjeteve të transportit të përdorura në objekt, garanton operimin e pandërprerë të tyre, furnizimin në kohë të fronteve të punës dhe realizimin e investimit sipas afateve dhe kërkesave teknike të vepres.

2.3.6 Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën, në datën e fundit të hapjes së ofertave ku te kete te punesuar minimumi 63(gjashtedhjetë e tre) persona.

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore në datën e fundit të hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në datën e fundit të hapjes së ofertave..

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është*

një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 42 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore).

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike dhe pajisjet si mëposhtë vijon;

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
2	Kamion me kapacitet mbajtes 10-13 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
3	Kamion me vinç	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
5	Eskavator me zinxhire me krah mbi 18m	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
6	Eskavator me goma (Mjet Teknologjik)	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
7	Dumper me kapacitet deri ne 6 ton (Mjet Teknologjik)	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
8	Minifadrome (Mjet Teknologjik)	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
9	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
10	Autobetoniere Vetengarkuese 2.5-3.5 m3 (Mjet Teknologjik)	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
11	Autopompe Betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
12	Pompe Stacionere Betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
13	Buldozer	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
14	Rrul ngjeshes gome cilinder me dhembeza me kapacitet min 18 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1

15	Autobot uji	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
16	Motogjenerator	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
17	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
18	Tokmak elektrik per ngjeshje dheu	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
19	Tranxhe per prerje hekuri	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
20	Bango per kthim hekuri	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
21	Betoforma	Ne pronesi ose me qera	m ²	400
22	GPS	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
23	Total Station	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
24	Kokore	Ne pronesi ose me qera	Cope	63
25	Jelek	Ne pronesi ose me qera	Cope	63
26	Fikese Zjarri te levizshme	Ne pronesi ose me qera	Cope	5
27	Tabela per sigurine ne objekt	Ne pronesi ose me qera	Cope	15
28	Komplet i ndihmes se shpejte	Ne pronesi ose me qera	Cope	5
29	Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5-2 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
30	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	Cope	2

Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje e noteruar.

- Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (orgjinal ose fotokopje e noteruar).
- Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet te mbuloje afatin e përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti,foto). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara te jenë të shoqëruara me foto.

- d) Autoriteti kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetësinë e deklaratës dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve në terren. Në rast deklarimi të rreme do të të veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar "për prokurimin publik".

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet "Deklaratë" nga administratori i shoqërisë ofertuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton - 3 (tre)

Qellimi i përdorimit

Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimal 20 ton përdoret për transportin e materialeve të gërmuara, materialeve inerte, gurit për gabione, materialeve mbushëse dhe materialeve të ndërtimit nga vendi i furnizimit në objekt dhe anasjelltas. Sistemi hidraulik i vetëshkarkimit mundëson shkarkim të shpejtë dhe të sigurt, duke reduktuar kohën e ciklit të transportit.

Për objektin "**Mbrojtja lumore në Urën e Shën Mrizës**", kjo makineri është një nga pajisjet kryesore për realizimin e punimeve.

Lidhja me zerrat e preventivin

Kamioni lidhet drejtpërdrejt me zërat:

- Gërmim dheu me eskavator.
- Transport dheu deri në 5 km.
- Transport gurësh për ndërtimin e gabioneve.
- Transport materialesh mbushëse.
- Transport agregatesh për beton.
- Transport materiale ndërtimi për veprat prej betoni dhe betonarmeje.

Lidhja me sasite e preventivit

Nga preventivi rezultojnë:

- Gërmime **1 736 m³**
- Transport dheu **15 467.58 m³**
- Gabione **337 m³**
- Beton (total)..... **1,957.78 m³**

Vetëm transporti i dheut përfaqëson mbi **15 mijë m³**, pa përfshirë transportin e gurëve për gabione dhe materialeve të betonit, çka krijon një volum shumë të madh transporti gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Llogaritja

Ku:

V = Vëllimi total i materialit (m³)

Q = Kapaciteti mesatar transportues për cikël (m³)

C = Numri mesatar i cikleve në orë

N = Numri i kamionëve

T = Koha e nevojshme (orë)

Formula:

$$T = V / (Q \times C \times N)$$

Llogaritja orientuese

$$V = 15\,467.58 \text{ m}^3$$

Kapaciteti mesatar efektiv i një kamioni 20 ton $\approx 12 \text{ m}^3$

Mesatarisht realizohen rreth 2 cikle/orë në kushte normale pune.

Kapaciteti orar i një kamioni:

$$12 \times 2 = \mathbf{24 \text{ m}^3/\text{orë}}$$

Tre kamionë realizojnë:

$$24 \times 3 = \mathbf{72 \text{ m}^3/\text{orë}}$$

Koha e nevojshme:

$$15\,467.58 / 72 = \mathbf{214.8 \text{ orë pune}}$$

Nëse punohet:

8 orë/ditë

rezultojnë:

$$214.8 / 8 = \mathbf{26.9 \text{ ditë pune efektive}}$$

Kjo kohë i referohet vetëm transportit të dheut dhe nuk përfshin transportin e gurëve për gabione, agregateve, çimentos dhe materialeve të tjera.

Argumentimi i numrit të makinerive

Kërkesa për **3 kamionë vetëshkarkues** është plotësisht e justifikuar sepse:

- objekti ka volum shumë të madh transporti;
- eskavatori nuk duhet të ndalojë për mungesë mjete transporti;
- puna zhvillohet paralelisht me gërmimet, mbushjet dhe ndërtimin e gabioneve;
- grafiku i punimeve është vetëm **6 muaj**, ndaj duhet të sigurohet ritëm i lartë ekzekutimi;
- një kamion është zakonisht në ngarkim, një në transport dhe një në shkarkim ose kthim, duke garantuar vazhdimësi të procesit pa ndërprerje.

Me vetëm 1 ose 2 kamionë do të krijoheshin pritje të vazhdueshme të eskavatorit, ulje e produktivitetit dhe rrezik për mosrespektimin e afatit .

Për këtë arsye, kërkesa për **3 kamionë vetëshkarkues me kapacitet min 20 ton** është teknikisht e arsyeshme, proporcionale me volumet e preventivit dhe e domosdoshme për realizimin e objektit brenda afatit 6-mujor.

2. Kamion me kapacitet mbajtës 10-13 ton 2 (dy)

Qellimi i përdorimit

Kamioni me kapacitet mbajtës 10–13 ton përdoret për transportin e agregateve, çimentos, armaturës, materialeve mbushëse, gurëve për gabione, kallëpeve dhe materialeve të tjera ndihmëse që kërkohen për realizimin e punimeve të betonit, betonarmesë dhe veprave të artit. Për shkak të dimensioneve më të vogla dhe manovrueshmërisë më të lartë, këta kamionë janë të përshtatshëm për furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës dhe lëvizjen brenda kantierit, aty ku kamionët vetëshkarkues 20 ton nuk janë praktikë

Lidhja me zerrat e preventivit

Kamionët me kapacitet 10–13 ton lidhen drejtpërdrejt me realizimin e zërave:

- Mbushje me zhavorr pas mureve – **115 m³**;
- Gabione me rrjetë teli të zinkuar – **337 m³**;
- F.V. Hekur betoni – **20.012 ton**;
- Strukturë monolite betoni – **980.96 m³**;
- Shtresë betoni C12/15 – **976.82 m**

Ndryshe nga kamionët vetëshkarkues 20 ton, të cilët përdoren kryesisht për transportin e dheut të gërmuar, këta kamionë shërbejnë për furnizimin e vazhdueshëm me materiale ndërtimore gjatë gjithë fazës së zbatimit.

Llogaritja e oreve të punës

Për përcaktimin e kohës së nevojshme të punës përdoren parametrat e mëposhtëm:

- **T** = Koha totale e punës (orë);
- **V** = Vëllimi i materialeve që transportohen (m³);
- **Q** = Kapaciteti mesatar transportues për një cikël (m³/cikël);
- **C** = Numri mesatar i cikleve që realizon një kamion në një orë (cikël/orë);
- **N** = Numri i kamionëve.

Formula e llogaritjes është:

$$T = V / (Q \times C \times N)$$

Për një kamion me kapacitet 10–13 ton merret:

- **Q = 10 m³/cikël**;
- **C = 2 cikle/orë**.

Prandaj produktiviteti i një kamioni është:

$$10 \times 2 = 20 \text{ m}^3/\text{orë}$$

Me **2 kamionë**, produktiviteti total bëhet:

$$20 \times 2 = 40 \text{ m}^3/\text{orë}$$

Për llogaritjen merret vëllimi i materialeve kryesore që kërkojnë furnizim me agregate dhe materiale ndërtimore:

- Strukturë monolite betoni **980.96 m³**
- Shtresë betoni C12/15 **976.82 m³**
- Mbushje me zhavorr **115.00 m³**
- Gabione **337.00 m³**

$$V = 980.96 + 976.82 + 115.00 + 337.00 = 2,409.78 \text{ m}^3$$

Zëvendësimi në formulë:

$$T = 2,409.78 / (10 \times 2 \times 2)$$

$$T = 2,409.78 / 40$$

$$T = 60.24 \text{ orë pune}$$

Në një regjim pune prej **8 orësh/ditë**, rezultojnë:

$$60.24 / 8 = 7.53 \text{ ditë pune efektive}$$

Kjo llogaritje mbulon vetëm transportin e agregateve dhe materialeve kryesore. Në praktikë, këta kamionë do të angazhohen edhe për transportin e **20.012 ton** armaturë, çimentos, kallëpeve, materialeve ndihmëse dhe pajisjeve të kantierit, të cilat nuk janë të shprehura në m³ në preventiv, por janë të domosdoshme për realizimin e punimeve. Për këtë arsye, angazhimi real i tyre është më i madh se 60.24 orë dhe shtrihet gjatë gjithë grafikut 6-mujor të punimeve.

Argumentimi i numrit të makinerive

Kërkesa për **2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës 10–13 ton** është teknikisht e justifikuar, pasi siguron furnizimin e pandërprerë të materialeve në frontet e punës, pa krijuar ndërprerje në proceset e betonimit, ndërtimit të gabioneve dhe realizimit të mbushjeve. Një kamion i vetëm nuk do të garantonte ritmin e nevojshëm të furnizimit, ndërsa dy kamionë mundësojnë zhvillimin paralel të proceseve të transportit dhe respektimin e afatit 6-mujor të zbatimit të punimeve. Ky argumentim është proporcional me natyrën e punimeve dhe me volumet e preventivit.

3. Kamion me vinçe 1 (nje)

Qellimi i përdorimit

Kamioni me vinç është një mjet transporti i pajisur me vinç hidraulik, i cili përdoret për transportin, ngarkimin, shkarkimin dhe vendosjen në pozicion të materialeve të rënda dhe elementëve të ndërtimit. Në këtë objekt ai është i domosdoshëm për shkarkimin dhe shpërndarjen e armaturës, materialeve për kallëpe, elementëve metalikë, tubacioneve, materialeve të organizimit të kantierit dhe pajisjeve të tjera që nuk mund të shkarkohen në mënyrë manuale ose me mjete të zakonshme.

Lidhja me zerrat e preventivit

Kamioni me vinç lidhet drejtpërdrejt me realizimin e zërave:

- F.V. Hekur betoni **20.012 ton**;
- Strukturë monolite betoni **980.96 m³**;
- Shtresë betoni C12/15 **976.82 m³**;
- Gabione **337.00 m³**, për transportin dhe shkarkimin e materialeve ndihmëse dhe elementëve të nevojshëm për montimin e tyre.

Kamioni me vinç nuk përdoret për transport masiv të dheut apo inerteve, por për materialet që kërkojnë ngritje mekanike dhe pozicionim të kontrolluar.

Llogaritja e oreve te punes

Për përcaktimin e kohës së nevojshme të punës përdoren parametrat e mëposhtëm:

- ✚ **T** = Koha totale e punës (orë);
- ✚ **V** = Sasia e materialit që ngarkohet dhe shkarkohet (ton);
- ✚ **Q** = Kapaciteti mesatar i ngritjes për një cikël (ton/cikël);
- ✚ **C** = Numri mesatar i cikleve që realizohen në një orë (cikël/orë);
- ✚ **N** = Numri i kamionëve me vinç.

Formula e llogaritjes është:

$$T = V / (Q \times C \times N)$$

Për kamionin me vinç merret:

- ✚ **Q = 3 ton/cikël**;
- ✚ **C = 2 cikle/orë**.

Produktiviteti orar rezulton:

$$3 \times 2 = 6 \text{ ton/orë}$$

Nga preventivi, vetëm sasia e armaturës është:

$$V = 20.012 \text{ ton}$$

Prandaj:

$$T = 20.012 / (3 \times 2 \times 1)$$

$$T = 20.012 / 6$$

$$T = 3.34 \text{ orë pune}$$

Kjo kohë përfaqëson vetëm ngarkimin dhe shkarkimin e armaturës.

Megjithatë, gjatë realizimit të objektit kamioni me vinç do të përdoret edhe për:

- ✚ shkarkimin e kallëpeve metalike dhe drusore;
- ✚ shkarkimin e tubacioneve dhe materialeve ndihmëse;
- ✚ shkarkimin e pajisjeve të kantierit;
- ✚ zhvendosjen e elementëve të rëndë ndërmjet fronteve të punës;
- ✚ ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve për betonimet.

Për shkak se këto materiale nuk pasqyrohen me peshë në preventiv, koha e mësipërme përfaqëson vetëm minimumin teorik të punës. Angazhimi real i kamionit me vinç gjatë gjithë periudhës së zbatimit është dukshëm më i madh dhe shtrihet përgjatë gjithë grafikut **6-mujor** të punimeve.

Argumentimi i numrit të kamionit me vinç

Kërkesa për **1 (një) kamion me vinç** është teknikisht e justifikuar dhe proporcionale me natyrën e punimeve. Operacionet e ngritjes dhe shkarkimit nuk zhvillohen njëkohësisht në disa fronte pune, ndaj një mjet është i mjaftueshëm për të përballuar të gjitha proceset. Prania e tij garanton shkarkimin dhe pozicionimin në kohë të materialeve të rënda, shmang dëmtimin e tyre gjatë manipulimit, rrit sigurinë në kantier dhe siguron vazhdimësinë e punimeve sipas grafikut 6-mujor. Për këto arsye, kërkesa për **1 (një) kamion me vinç** konsiderohet e arsyeshme dhe në përpjesëtim me volumet dhe natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv.

4. Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton 1 (nje)

Qellimi i përdorimit

Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5–5 ton përdoret për transportin e materialeve të lehta dhe të mesme, veglave të punës, pajisjeve topografike, materialeve për kallëpe, çimentos së ambalazhuar, elementëve metalikë, materialeve ndihmëse, pajisjeve të kantierit dhe furnizimeve të nevojshme për zhvillimin e punimeve. Për shkak të përmasave të saj kompakte dhe manovrueshmërisë së lartë, kjo makineri mund të lëvizë lehtësisht në të gjitha frontet e punës dhe në hapësira ku kamionët me kapacitet më të madh nuk mund të operojnë me efikasitet.

Lidhja me zerrat e preventivit

Kamionçina lidhet drejtpërdrejt me realizimin e zërave:

- ✚ F.V. Hekur betoni – **20.012 ton**;
- ✚ Strukturë monolite betoni – **980.96 m³**;
- ✚ Shtresë betoni C12/15 – **976.82 m³**;
- ✚ Gabione – **337.00 m³**;
- ✚ Mbushje me zhavorr – **115.00 m³**.

Kamionçina nuk përdoret për transportin e masave të mëdha të dheut apo agregateve, por për furnizimin e vazhdueshëm të kantierit me materiale dhe pajisje që janë të domosdoshme për realizimin e punimeve.

Llogaritja e oreve të punës

Për përcaktimin e kohës së nevojshme të punës përdoren parametrat e mëposhtëm:

- T = Koha totale e punës (orë);
- V = Sasia e materialeve që transportohen (ton);
- Q = Kapaciteti mesatar transportues për një cikël (ton/cikël);
- C = Numri mesatar i cikleve të transportit që realizon një kamionçinë në një orë (cikël/orë);
- N = Numri i kamionçinave.

Formula e llogaritjes është:

$$T = V / (Q \times C \times N)$$

Për kamionçinën merret:

- $Q = 4 \text{ ton/cikël}$;
- $C = 2 \text{ cikle/orë}$.

Kapaciteti orar i një kamionçine është:

- $4 \times 2 = 8 \text{ ton/orë}$

Me **1 kamionçinë**, kapaciteti total bëhet:

- $8 \times 1 = 8 \text{ ton/orë}$

Nga preventivi rezulton se vetëm armatura është **20.012 ton**.

Prandaj:

- $T = 20.012 / (4 \times 2 \times 1)$
- $T = 20.012 / 8$
- $T = 2.5 \text{ orë pune}$

Kjo kohë përfaqëson vetëm transportin e armaturës.

Megjithatë, kamionçina do të përdoret gjithashtu gjatë gjithë periudhës së zbatimit për transportin e çimentos së ambalazhuar, materialeve për kallëpe, elementëve metalikë, veglave të punës, pajisjeve topografike, materialeve ndihmëse për realizimin e **1,957.78 m³ beton**, si dhe për furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës me materiale që nuk pasqyrohen si volume të veçanta në preventiv. Për këtë arsye, koha e llogaritur përfaqëson vetëm minimumin teorik, ndërsa angazhimi real i 1 (nje) kamionçine shtrihet përgjatë gjithë grafikut **6-mujor** të punimeve.

Argumenti i numrit te kamioncines

Kërkesa për 1 (nje) kamionçine me kapacitet mbajtës 3.5–5 ton është teknikisht e justifikuar.

5. Eskavator me zinxhir me krah mbi 18 m - 2 (dy)

Qellimi i perdorimit

Eskavatori me zinxhir me krah mbi 18 m është një nga makineritë kryesore të këtij objekti. Për shkak se punimet zhvillohen në shtratin dhe brigjet e lumit, krahu i gjatë mundëson realizimin e gërmimeve, sistemimin e brigjeve dhe vendosjen e materialeve pa qenë e nevojshme që makineria të futet në shtrat ose në zona me stabilitet të ulët. Zinxhirët sigurojnë qëndrueshmëri dhe aftësi të lartë lëvizjeje në terren me lagështi dhe me kapacitet mbajtës të kufizuar.

Lidhja me preventivin

Kjo makineri lidhet drejtpërdrejt me realizimin e zërave:

- ✚ Gërmim dheu me eskavator.
- ✚ Transport dheu.
- ✚ Sistemim i trupit të digës.
- ✚ Mbushje me zhavorr pas mureve.
- ✚ Ndërtim gabionesh.
- ✚ Sistemim i shtratit të lumit.

Lidhja me sasite e preventivit

Punimet që realizohen me ndihmën e kësaj makinerie përfshijnë:

- ✚ Gërmime..... 1 736 m³
- ✚ Transport materiali..... 15 467.58 m³
- ✚ Ngjeshje..... 12 435.49 m³
- ✚ Mbushje me zhavorr..... 115 m³
- ✚ Gabione..... 337 m³

Volumi i punimeve nuk përfshin vetëm gërmimin fillestar, por edhe sistemimin e brigjeve, ngarkimin e materialit në kamionë, profilimin e seksioneve dhe asistencën gjatë vendosjes së gurëve për gabione.

Llogaritja

Ku:

T = Koha e punës (orë)

V = Vëllimi i punimeve (m³)

P = Produktiviteti mesatar i një eskavatori (m³/orë)

N = Numri i eskavatorëve

Formula:

$$\mathbf{T = V / (P \times N)}$$

Llogaritja e oreve te punes

Për eskavator me krah të gjatë merret produktivitet mesatar:

$$\mathbf{P = 35\ m^3/orë}$$

Vëllimi minimal i gërmimeve:

$$\mathbf{V = 1\ 736\ m^3}$$

Me dy eskavatorë:

Kapaciteti total:

$$\mathbf{35 \times 2 = 70\ m^3/orë}$$

Koha:

$$\mathbf{1\ 736 / 70 = 24.80\ orë\ pune}$$

Në ditë pune:

$$\mathbf{24.80 / 8 = 3.10\ ditë\ pune}$$

Megjithatë kjo kohë përfaqëson vetëm gërmimin fillestar.

Eskavatori do të angazhohet gjithashtu në:

- profilimin e brigjeve;
- sistemimin e shtratit;
- ngarkimin e materialeve;
- asistencën gjatë mbushjeve;
- pozicionimin e gurëve për gabione;
- pastrimin e zonës së punimeve.

Duke përfshirë të gjitha këto procese, angazhimi real i secilit eskavator është disa herë më i madh dhe shtrihet gjatë gjithë grafikut 6-mujor të punimeve.

Argumentimi i numrit te eskavatoreve

Kërkesa për **2 eskavatorë me zinxhir dhe krah mbi 18 m** është plotësisht e justifikuar, pasi:

- ✚ një eskavator realizon gërmimet kryesore dhe ngarkimin e materialeve në kamionë;
- ✚ eskavatori i dytë kryen profilimin e brigjeve, sistemimin e shtratit të lumit dhe asiston në vendosjen e gurëve të gabioneve;
- ✚ puna në dy fronte njëkohësisht shmang ndërprerjet e procesit të ndërtimit;
- ✚ koha e punes prej vetëm **6 muajsh** kërkon zhvillimin paralel të proceseve të gërmimit, transportit dhe ndërtimit të gabioneve;
- ✚ përdorimi i vetëm një eskavatori do të krijonte vonesa në zinxhirin teknologjik, duke penguar kamionët, buldozerin, autogradën dhe ekipet e ndërtimit.

Për këto arsye, disponimi i **2 eskavatorëve me zinxhir me krah mbi 18 m** është teknikisht proporcional me volumet e preventivit dhe i domosdoshëm për realizimin e objektit brenda afatit.

6. Eskavator me goma (Mjet Teknologjik) 2 (dy)

Qellimi i perdorimit

Kërkesa për disponimin e **2 (dy) eskavatore me goma (Mjet Teknologjik)** janë përcaktuar mbi bazën e analizës së preventivit, organizimit teknologjik të punimeve dhe afatit të realizimit prej **6 (gjashtë) muajsh**, duke garantuar realizimin e proceseve ndihmëse dhe mbështetëse të ndërtimit, pa krijuar mbivendosje me funksionet e eskavatorëve me zinxhir.

Eskavoret me goma janë mjete teknologjik me lëvizshmëri të lartë, i projektuar për punime që kërkojnë zhvendosje të shpeshta përgjatë kantierit dhe ndërhyrje në disa fronte pune. Ndryshe nga eskavatori me zinxhir, i cili është argumentuar për realizimin e gërmimeve kryesore dhe punimeve të rënda, eskavoret me goma shërbejnë për proceset ndihmëse që garantojnë vazhdimësinë e ciklit teknologjik të ndërtimit.

Lidhja me zerat e preventivit

Bazuar në preventiv, eskavatori me goma angazhohet në proceset teknologjike të lidhura me këta zëra:

- ✚ **Transporti i 1,736 m³ material gërmimi**, ku realizon ngarkimin e materialit në automjetet e transportit.
- ✚ **Mbushja me 12,435.49 m³ zhavorr pas mureve**, ku kryen shpërndarjen, sistemimin dhe profilimin e materialit gjatë fazës së mbushjes.
- ✚ **Ndërtimi i 337 m³ gabioneve**, ku realizon sistemimin e bazamentit, lëvizjen e materialeve dhe asiston në mbushjen e strukturave me gurë.
- ✚ **Realizimi i 980.96 m³ strukturave monolite prej betoni C16/20**, ku merr pjesë në pastrimin dhe përgatitjen e bazamenteve para betonimit dhe largimin e materialeve të tepërta pas përfundimit të punimeve.
- ✚ **Realizimi i 976.82 m² shtresë betoni C12/15**, ku kryen sistemimin dhe profilimin e sipërfaqes mbështetëse përpara vendosjes së shtresës së betonit.

Këto procese nuk përfaqësojnë betonimin apo ndërtimin e gabioneve në vetvete, por operacionet teknologjike paraprake dhe ndihmëse që realizohen me eskavator me goma dhe janë të domosdoshme për vijimësinë normale të punimeve.

Analiza e kapacitetit të mjetit

Për vlerësimin e kapacitetit të nevojshëm përdoret formula:

$$N = V / (P \times T \times K)$$

ku:

- ✚ N = numri i mjeteve të nevojshme;
- ✚ V = volumi i proceseve ku angazhohet eskavatori (m³);
- ✚ P = produktiviteti mesatar i eskavatorit (m³/orë);
- ✚ T = koha efektive e punës gjatë kontratës (orë);
- ✚ K = koeficienti i shfrytëzimit të mjetit.

Percaktimi i kohës

Afati i realizimit të kontratës është **6 muaj**.

Duke konsideruar mesatarisht:

- ✚ **22 ditë pune/muaj;**
- ✚ **8 orë pune/ditë,**

rezulton:

$$T = 6 \times 22 \times 8 = 1,056 \text{ orë}$$

Produktiviteti

Për një eskavator me goma me kapacitet kove **0.25 m³**, në punime sistemimi, ngarkimi dhe profilimi merret produktivitet mesatar:

$$P = 20 \text{ m}^3/\text{orë}$$

Kapaciteti efektiv i mjetit gjatë gjithë punimeve është:

$$P \times T \times K$$

$$= 20 \times 1,056 \times 0.75$$

$$= 15,840 \text{ m}^3$$

Proceset teknologjike të lidhura me sistemimin e mbushjeve me zhavorr, përgatitjen e bazamenteve të gabioneve, ngarkimin e materialeve të gërmuara dhe sistemimin e sipërfaqeve për

betonim zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit të vepres dhe përfshijnë një volum pune që mbulohet nga kapaciteti efektiv i **2 (dy) eskavatoret me goma**.

Si perfundim

Në analizë të preventivit, organizimit të kantierit dhe afatit 6-mujor të realizimit, rezulton se **2 (dy) eskavator me goma** janë të mjaftueshëm për të garantuar realizimin e proceseve teknologjike ndihmëse pa mbivendosur funksionet e **2 eskavatorëve me zinxhir**, të cilët janë parashikuar për gërmimet kryesore. Për rrjedhojë, kërkesa për **2 (dy) eskavator me goma (Mjet Teknologjik)** është proporcionale me natyrën dhe volumet e punimeve të preventivit, garanton realizimin e investimit brenda afatit dhe respekton parimin e proporcionalitetit në përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

7. Dumper me kapacitet deri në 6 Ton (Mjet Teknologjik)- 2 (dy)

Qellimi i përdorimit

Kërkesa për disponimin e **2 (dy) Dumperëve me kapacitet deri në 6 ton** është përcaktuar në funksion të organizimit të punimeve në kantier, natyrës së objektit dhe afatit të realizimit prej **6 (gjashtë) muajsh**. Dumperi është mjet teknologjik i projektuar për transport të materialeve brenda kantierit dhe në terrene ku automjetet e zakonshme të transportit nuk mund të punojnë me të njëjtin efikasitet.

Ndryshe nga automjetet e transportit rrugor, dumperi siguron furnizimin e pandërprerë të fronteve të punës me materiale dhe largimin e materialeve të tepërta në distanca të shkurtra, duke shmangur ndërprerjet e proceseve teknologjike.

Lidhja me zerat dhe volume e preventivit

Bazuar në preventiv, dumperi angazhohet në proceset teknologjike të lidhura me këto volume:

- ✚ Transporti i **1,736.00 m³** material gërmimi brenda ciklit të ngarkim-shkarkimit.
- ✚ Furnizimi me **12,435.49 m³** zhavorr për mbushjet pas mureve, ku materiali shpërndahet në mënyrë graduale përgjatë fronteve të punës.
- ✚ Transporti i gurëve për realizimin e **337.00 m³** gabioneve.
- ✚ Furnizimi me agregate dhe materiale ndihmëse për realizimin e **980.96 m³** strukturave monolite prej betoni C16/20.
- ✚ Furnizimi me materiale për përgatitjen e **976.82 m²** shtresë betoni C12/15.

Dumperi nuk realizon vetë punimet e mbushjes, betonimit apo ndërtimit të gabioneve, por është mjeti që garanton furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës me materialet e nevojshme dhe largimin e materialeve të tepërta gjatë gjithë ciklit të ndërtimit.

Analiza teknike

Për përcaktimin e numrit minimal të mjeteve përdoret formula:

$$N = V / (P \times T \times K)$$

ku:

- ✚ N = numri i mjeteve të nevojshme;
- ✚ V = volumi i materialeve që transportohen (m³);
- ✚ P = produktiviteti mesatar i një dumperi (m³/orë);
- ✚ T = koha efektive e punës (orë);
- ✚ K = koeficienti i shfrytëzimit.

Koha efektive

Afati kontraktor është **6 muaj**.

Mesatarisht:

- 22 ditë pune/muaj;
- 8 orë pune/ditë.

Prandaj:

$$T = 6 \times 22 \times 8 = 1,056 \text{ orë}$$

Produktiviteti

Për një dumper me kapacitet deri në **6 ton**, në kushte normale pune, merret produktivitet mesatar:

$$P = 18 \text{ m}^3/\text{orë}$$

Koeficienti i shfrytëzimit:

$$K = 0.75$$

Kapaciteti efektiv i një dumperi rezulton:

$$P \times T \times K = 18 \times 1,056 \times 0.75 = 14,256 \text{ m}^3$$

Argumenti i numrit të mjeteve Dumper

Nga analiza e kapacitetit rezulton se, **nga pikëpamja teorike**, një dumper mund të përballojë volumnin e transportit gjatë afatit .

Megjithatë, gjatë zbatimit të objektit, transporti i materialeve zhvillohet paralelisht në disa procese teknologjike. Në të njëjtën periudhë realizohen mbushjet me zhavorr, furnizimi i fronteve të gabioneve, largimi i materialeve nga gërmimet dhe furnizimi i punimeve të betonit. Përdorimi i

vetëm një dumperi do të krijonte ndërprerje në furnizimin e fronteve të punës dhe kohë pritjeje për makineritë e tjera.

Për këtë arsye, **2 (dy) dumperë** konsiderohen të justifikueshëm **pasi grafiku i punimeve parashikon zhvillimin paralel të këtyre proceseve.**

8. Minifadrome (Mjet Teknologjik) 2 (dy)

Qellimi i perdorimit

Kërkesa për disponimin e **2 (dy) Minifadromave (Mjete Teknologjike)** është përcaktuar në përputhje me natyrën e punimeve, volumet e preventivit dhe afatin kontraktor prej **6 (gjashtë) muajsh**, me qëllim garantimin e furnizimit të pandërprerë të fronteve të punës, sistemimin e materialeve dhe realizimin e proceseve teknologjike ndihmëse gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Minifadroma është mjet teknologjik me dimensione kompakte dhe manovrueshmëri të lartë, i projektuar për ngarkimin, shpërndarjen, sistemimin dhe lëvizjen e materialeve në hapësira të kufizuara, ku përdorimi i fadromave me kapacitet të madh ose makinerive të tjera të rënda nuk është ekonomik dhe nuk garanton të njëjtin efikasitet operacional.

Ndryshe nga eskavatori me zinxhir, i cili realizon gërmimet, dhe eskavatori me goma, i cili kryen punime të profilimit dhe sistemimit, minifadroma përdoret kryesisht për ngarkimin dhe shpërndarjen e materialeve të depozituara në kantier, furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës dhe pastrimin e sipërfaqeve gjatë zhvillimit të punimeve.

Lidhja me zerrat dhe volume e preventivit

Nga analiza e preventivit rezulton se minifadroma angazhohet drejtpërdrejt në proceset teknologjike që lidhen me këto volume:

 Mbushje me zhavorr pas mureve	12,435.49 m³
 Gabione me rrjeta teli të zinguar	337 m³
 Struktura monolite betoni C16/20	980.96 m³
 Shtresë betoni C12/15	976.82 m²

Në zërin e mbushjes me zhavorr, minifadroma realizon ngarkimin, shpërndarjen dhe sistemimin e materialit përgjatë zonës së punës, duke siguruar furnizimin e vazhdueshëm të mjeteve të ngjeshjes dhe përfundimin e mbushjeve sipas parametrave të projektit.

Në realizimin e **337m³ gabioneve**, minifadroma përdoret për transportin në distanca të shkurtra brenda kantierit, sistemimin e gurëve pranë vendit të montimit dhe pastrimin e vazhdueshëm të zonës së punës.

Për realizimin e **980.96 m³ strukturave monolite prej betoni C16/20**, si dhe **976.82 m² shtresë betoni C12/15**, minifadroma angazhohet në furnizimin me agregate, largimin e materialeve të tepërta, sistemimin e bazamenteve dhe pastrimin e sipërfaqeve para dhe pas betonimit.

Analize Teknike

Për përcaktimin e numrit të mjeteve përdoret formula:

$$N = V / (P \times T \times K)$$

ku:

- N = numri i mjeteve të nevojshme;
- V = volumi i proceseve ku angazhohet minifadroma;
- P = produktiviteti mesatar i minifadromës ($m^3/orë$);
- T = koha efektive e punës gjatë kontratës (orë);
- K = koeficienti i shfrytëzimit të mjetit.

Percaktimi i kohes

Afati kontraktor është **6 muaj**.

Duke konsideruar:

- ✚ **22 ditë pune/muaj;**
- ✚ **8 orë pune/ditë,**

rezulton:

$$T = 6 \times 22 \times 8 = 1,056 \text{ orë}$$

Produktiviteti

Për një minifadromë merret produktivitet mesatar:

$$P = 15 \text{ m}^3/\text{orë}$$

Koeficienti i shfrytëzimit të mjetit merret:

$$K = 0.75$$

Kapaciteti efektiv i një minifadrome gjatë periudhës kontraktore është:

$$P \times T \times K = 15 \times 1,056 \times 0.75 = 11,880 \text{ m}^3$$

Argumentimi i numrit te mjeteve

Volumi i mbushjeve me zhavorr (**12,435.49 m³**) tejkalon kapacitetin efektiv teorik të një minifadrome (**11,880 m³**). Përveç këtij volumi, gjatë të njëjtës periudhë realizohen edhe proceset ndihmëse për **337 m³ gabione**, **980.96 m³ struktura monolite betoni** dhe **976.82 m² shtresë betoni**, të cilat kërkojnë angazhim të vazhdueshëm të minifadromës për furnizimin dhe sistemimin e materialeve.

Për rrjedhojë, përdorimi i vetëm një minifadrome nuk garanton furnizimin në kohë të fronteve të punës dhe do të krijonte ndërprerje në proceset teknologjike. Disponimi i **2 (dy) minifadromave** mundëson zhvillimin paralel të punimeve, furnizimin e njëkohshëm të fronteve të ndryshme dhe realizimin e volumit të preventivit brenda afatit prej 6 muajsh.

Si perfundim

Në analizë të volumeve të preventivit, organizimit të punimeve dhe afatit kontraktor, rezulton se kërkesa për **2 (dy) Minifadroma (Mjete Teknologjike)** është teknikisht e argumentuar dhe proporcionale me natyrën e objektit. Këto mjete janë të domosdoshme për ngarkimin, shpërndarjen dhe sistemimin e materialeve në kantier, duke garantuar vijimësinë e proceseve teknologjike, realizimin e punimeve sipas grafikut 6-mujor dhe përfundimin e investimit në afat.

9. Minieskavator 1 (nje)

Qellimi i perdorimit

Kërkesa për disponimin e **1 (një) Minieskavatori (Mjet Teknologjik)** është përcaktuar në funksion të natyrës së punimeve, volumeve të preventivit dhe organizimit të procesit të ndërtimit, me qëllim realizimin e punimeve që kërkojnë saktësi të lartë, ndërhyrje në hapësira të kufizuara dhe mbështetje të proceseve teknologjike gjatë afatit kontraktor prej **6 (gjashtë) muajsh**.

Minieskavatori është mjet teknologjik me përmasa kompakte, i projektuar për punime që nuk mund të realizohen me efikasitet nga eskavatorët me zinxhir ose eskavatori me goma, për shkak të dimensioneve të tyre më të mëdha. Ai përdoret për profilime të imëta, pastrimin e bazamenteve, sistemimin e skajeve të gërmimeve, përgatitjen e zonave të punës për vendosjen e gabioneve, si dhe për sistemimin e sipërfaqeve përpara realizimit të strukturave të betonit.

Lidhja me zerat dhe volume e preventivit

Nga analiza e preventivit rezulton se minieskavatori angazhohet në proceset teknologjike që lidhen me:

- ✚ **Gërmimet me eskavator me goma** **1,736 m³**, duke realizuar pastrimin dhe profilimin e pjesëve që kërkojnë ndërhyrje me saktësi.
- ✚ **Gabionet me rrjeta teli të zinguar** **337m³**, ku kryen përgatitjen e bazamenteve, sistemimin e kontureve dhe korrigjimet lokale para vendosjes së gabioneve.
- ✚ **Strukturat monolite prej betoni C16/20** **980.96 m³**, ku realizon pastrimin dhe sistemimin përfundimtar të bazamenteve para betonimit.
- ✚ **Shtresën e betonit C12/15** **976.82 m²**, ku përgatit sipërfaqen mbështetëse dhe eliminon parregullsitë lokale përpara hedhjes së betonit.

Minieskavatori nuk zëvendëson eskavatorët e tjerë në realizimin e gërmimeve apo të mbushjeve masive, por kryen ndërhyrje të specializuara që kërkojnë saktësi dhe manovrim në zona të kufizuara, duke siguruar përmbushjen e kërkesave teknike të projektit.

Analiza teknike

Për përcaktimin e numrit të mjeteve përdoret formula:

$$N = V / (P \times T \times K)$$

ku:

- **N** = numri i mjeteve të nevojshme;
- **V** = volumi i punimeve ku angazhohet minieskavatori;
- **P** = produktiviteti mesatar i minieskavatorit (m³/orë);
- **T** = koha efektive e punës gjatë kontratës (orë);
- **K** = koeficienti i shfrytëzimit të mjetit.

Percaktimi i kohes efektive

Afati i grafikut është **6 muaj**.

Duke marrë në konsideratë:

- ✚ **22 ditë pune/muaj;**
- ✚ **8 orë pune/ditë,**

rezulton:

$$T = 6 \times 22 \times 8 = 1,056 \text{ orë}$$

Produktiviteti

Për një minieskavator merret produktivitet mesatar:

$$P = 8 \text{ m}^3/\text{orë}$$

Koeficienti i shfrytëzimit:

$$K = 0.75$$

Kapaciteti efektiv i mjetit rezulton:

$$P \times T \times K = 8 \times 1,056 \times 0.75 = 6,336 \text{ m}^3$$

Kapaciteti efektiv i një minieskavatori mbulon plotësisht proceset teknologjike të specializuara që i janë dedikuar këtij mjeti gjatë realizimit të objektit. Për shkak se punimet që kryen janë të lokalizuara, me volum më të kufizuar por me kërkesa të larta për saktësi, **1 (një) minieskavator** është i mjaftueshëm për të garantuar realizimin e tyre brenda afatit.

Si perfundim

Në analizë të preventivit, volumeve të punimeve dhe organizimit të kantierit, rezulton se kërkesa për **1 (një) Minieskavator (Mjet Teknologjik)** është teknikisht e argumentuar dhe proporcionale me objektin e prokurimit. Ky mjet është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të profilimit, sistemimit dhe përgatitjes së bazamenteve në hapësira të kufizuara, duke plotësuar funksionet e makinerive të tjera pa mbivendosje dhe duke garantuar realizimin cilësor të punimeve brenda afatit 6-mujor.

10. Autobetoniere Vetëngarkuese 2.5-3.5 m³ (Mjet Teknologjik)

2 (dy)

Qelimi i përdorimit

Kërkesa për disponimin e **2 (dy) Autobetoniere Vetëngarkuese me kapacitet 2.5–3.5 m³ (Mjet Teknologjik)** është përcaktuar në përputhje me natyrën e punimeve, volumet e preventivit dhe afatin e realizimit të kontratës prej **6 (gjashtë) muajsh**, me qëllim garantimin e prodhimit, përzierjes, transportit dhe furnizimit të vazhdueshëm me beton gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Autobetonieret vetëngarkuese janë mjet teknologjik të specializuar, të cilat realizojnë në mënyrë të integruar ngarkimin e lëndëve të para, dozimin, përzierjen, transportin dhe shkarkimin e betonit në vendin e punës. Përdorimi i këtyre mjeteve siguron ruajtjen e cilësisë së përzierjes së betonit, respektimin e parametrave teknikë të projektit dhe furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës sipas grafikut të zbatimit.

